# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6192
E mërkurë, 16 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €


## Osmani qëndron për vizitë zyrtare treditore në Shqipëri

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


REPUBLIKA E KOSOVËS PËRBALLË PANDEMISË COVID-19 FAQE 4-5

# 293 PJESËTARË TË POLICISË TË INFEKTUAR ME COVID




Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka bërë me dije të martën se janë 293 pjesëtarë të policisë të infektuar me Covid-19, ndërsa në izolim janë 234 policë. Ai ka treguar se 12 policë kanë vdekur si pasojë e këtij virusi. Mehmeti ka thënë se vendimet e Qeverisë së Kosovës janë duke u respektuar nga ana Policia e Kosovës. Të martën ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka raportuar në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me menaxhimin e situatës me Covid-19, me ç'rast ka theksuar se shqetësuese mbetet numri i rasteve të të vdekurve. Vetëm gjatë 24 orë të fundit si pasojë e këtij virusi kanë vdekur edhe 17 persona

KOLEGJI ZGJEDHOR NË SHBA KONFIRMON FITOREN E JOE BIDENIT



# BIDENI, PAS KONFIRMIMIT TË FITORES: ËSHTË KOHA PËR FILLIM TË RI

FAQE 2

Presidenti i zgjedhur amerikan, Joe Biden, ka thënë se është koha për një fillim të ri, pasi i është konfirmuar fitorja nga Kolegji Elektoral. Në një fjalim të mbajtur pas njoftimit për fitore, ai ka thënë se demokracia e Shteteve të Bashkuara "është testuar dhe kërcënuar", si dhe ka rezultuar se "e merr veten shpejt, është e vërtetë dhe e fuqishme"

## ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME DO TË PROVOKOJNË ZGJEDHJE TË TJERA TË JASHTËZAKONSHME

FAQE 10-11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE




### NAIM FETAHU JEP DORËHEQJE NGA POZITA E KRYETARIT TË DEGËS SË PDK-së NË PODUJEVË

F. 7

### NASIM HARADINAJ TË PREMTEN PARAQITET PARA SPECIALES

F. 7



### LUTFI HAZIRI: PO SHKOJMË DREJT ZGJEDHJEVE

F. 3

### 75 PËR QIND E TË HYRAVE TË POSTËS SHPENZOHEN PËR PAGA

F. 8

### FSHATI GJONAJ I PRIZRENIT TASH E TUTJE DO TË KETË 24 ORË UJË TË PIJSHËM

F. 6

## EKONOMI

### 850 FERMERË PRITET TË PËRFITOJNË GRANTE NË VLERË PREJ 29 MILIONË EUROSH

F. 9

### GASTRONOMËT KËRKOJNË ZGJATJEN E ORARIT PËR BIZNESET

F. 8




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Kolegji Zgjedhor në ShBA konfirmon fitoren e Joe Bidenit

# Bideni, pas konfirmimit të fitores: Është koha për fillim të ri

Presidenti i zgjedhur amerikan, Joe Biden, ka thënë se është koha për një fillim të ri, pasi i është konfirmuar fitorja nga Kolegji Elektoral. Në një fjalim të mbajtur pas njoftimit për fitore, ai ka thënë se demokracia e Shteteve të Bashkuara "është testuar dhe kërcënuar" si dhe ka rezultuar se "e merr veten shpejt, është e vërtetë dhe e fuqishme"



UASHINGTON, 15 DHJETOR - Demokrati Joe Biden fitoi votimin shtet për shtet të Kolegjit Zgjedhor, që përcakton zyrtarisht presidencën në ShBA. Presidenti i zgjedhur amerikan Joe Biden ka thënë se është koha për një fillim të ri, pasi i është konfirmuar fitorja nga Kolegji Elektoral më 14 dhjetor. Në një fjalim të mbajtur pas njoftimit për fitore, ai ka thënë se demokracia e Shteteve të Bashkuara "është testuar dhe kërcënuar" si dhe ka rezultuar se "e merr veten shpejt, është e vërtetë dhe e fuqishme". Ai ka dënuar tentimet e presidentit amerikan Donald Trump për ta përmbysur rezultatin dhe ka thënë se "dëshira e popullit ka triumfuar".

Konfirmimi i fitores së tij ka qenë një prej hapave të nevojshëm, ashtu që Biden ta fitojë pozitën në Shtëpinë e Bardhë. Sipas sistemit amerikan, votuesit votojnë për "përfaqësuesit" e tyre, të cilët më pas zyrtarisht votojnë për kandidatët, disa javë pas zgjedhjeve.

Demokrati Joe Biden ka fituar 306 vota elektorale për dallim nga Trump që ka fituar 232.

Presidenti Trump, që ka treguar pak shenja të humbjes, nuk ka komentuar rezultatin. Mirëpo Biden, në anën tjetër, duke folur nga Delauer, ka lavdëruar "burrat dhe gratë" që kanë refuzuar të nënshtrohen, duke iu referuar përpjekjeve të presidentit për t'i përmbysur zgjedhjet, duke përfshirë beteja ligjore të cilat janë hedhur poshtë në gjithë shtetin. "Flaka e demokracisë në këtë komb është ndezur shumë kohë më parë", ka thënë ai. "Dhe ne e dimë se asgjë, madje as një pandemi, apo abuzim me pushtetin nuk mund ta shuajë atë flakë".

Biden, mes të tjerash, ka bërë thirrje që, ashtu sikur edhe në periudha të tjera të historisë, është koha që kombi amerikan të bashkohet dhe të shërohet.

Zgjedhjet presidenciale në ShBA janë mbajtur më 3 nëntor.

Bideni nis zyrtarisht punën si president më 20 janar të vitit të ardhshëm.

# Numër rekord i gazetarëve të burgosur në 2020-n



NJU-JORK, 15 DHJETOR - Një numër rekord i gazetarëve janë burgosur më 2020, meqë qeveritë kanë shtypur mbulimin e situatës së krijuar nga pandemia e koronavirusit, apo kanë tentuar t'i shtypin raportimet për pakënaqësi civile, ka thënë Komiteti për Mbrojtje të Gazetarëve të martën. Të paktën 274 gazetarë kanë qenë në burg deri më 1 dhjetor, më së shumti prej kur grupi me bazë në Nju-Jork ka nisur të mbledhë të dhëna në fillim të viteve 1990, është thënë në raport.

Sipas këtij Komiteti, vitin e kaluar janë regjistruar 250 gazetarë të burgosur.

Protestat dhe tensionet politike kanë qenë shkaktare të shumicës së arrestimeve që janë bërë kryesisht në Kinë, Turqi, Egjipt dhe Arabi Saudite.

Në valën e pandemisë së koronavirusit, liderët autoritarë kanë tentuar ta kontrollojnë raportimin, duke arrestuar gazetarët. Të paktën dy gazetarë kanë vdekur pasi janë prekur nga sëmundja Covid-19 që shkakton ky virus, sa kanë qenë në mbajtje, ka theksuar raporti.

Në nivel global është thënë se 34 gazetarë janë burgosur për "lajme të rreme" më 2020, në krahasim me 31 vitin e kaluar.

Ndonëse asnjë gazetar nuk ka qenë në burg në Shtetet e Bashkuara deri më 1 dhjetor, 110 janë arrestuar apo akuzuar gjatë këtij viti, shumica prej të cilëve teksa kanë qenë duke mbuluar protestat kundër dhunës policore është thënë, mes të tjerash, në raport. Shtetet ku numri i gazetarëve të burgosur është rritur dukshëm janë Bjellorusia dhe Etiopia.

## Evropa në bllokim para Krishtlindjes dhe Vitit të Ri



BERLIN, 15 DHJETOR - Një numër vendesh evropiane kanë vendosur masa të rrepta të kufizimeve para festës së Krishtlindjes, pa një rritjeje të numrit të të infektuarve. Holanda ka vendosur një bllokim pesëjavor, duke mbyllur dyqanet jothelbësore, teatrot dhe palestrat.

Gjermania, ndërkohë, nga data 15 dhjetor do të hyjë në një bllokim të rreptë, pasi numri i të infektuarve ka arritur në nivele rekord.

Franca ka lehtësuar disa masa por, megjithatë, shumë kufizime do të mbesin në fuqi pasi numri i të prekurve nga sëmundja Covid-19 është akoma i lartë.

Italia, Spanja, Franca dhe Britania e Madhe janë ndër vendet që kanë regjistruar numrin më të lartë të rasteve gjatë pandemisë.

Javët e fundit qeveritë e vendeve evropiane janë përballur me dilema të vështira nëse duhet t'i lehtësojnë kufizimet për periudhën e pushimeve.

Por, vala e fundit e të infektuarve në disa vende i ka shtyrë qeveritë t'i ndalojnë planet për t'i zbutur rregullat.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Lutfi Haziri: Po shkojmë drejt zgjedhjeve



Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka bërë me dije se vendi është duke shkruar drejt zgjedhjeve të reja parlamentare. "Në qoftë se nuk do të ketë marrëveshje, atëherë nuk ka tjetër opsion. Më shumë po shkojmë drejt zgjedhjeve", ka thënë Haziri

**Prishtinë, 15 dhjetor-** Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ideja e liderit të kësaj partie, Isa Mustafa, është ta ftojë tryezën e partive politike për të nisur dialogun e brendshëm për zgjedhjen e presidentit. "Është duke bërë përpjekje që sa kohë, por po presim konfirmimin e partive. Në qoftë se nuk do të ketë marrëveshje, atëherë nuk ka tjetër opsion. Më shumë po shkojmë drejt zgjedhjeve. Duhet përgatitur patjetër dhe që të gjithë janë të përgatitur (për zgjedhje). Por, ato nuk janë të mirëpritura për vendin dhe për stabilitetin politik. Nuk po shoh se mund të prodhohet zgjidhje e qëndrueshme pas zgjedhjeve. Do të hyjmë në një cikël të ri të krizave politike. Nëse mungon vullneti politik që të zgjidhen problemet sot në tavolinë, do të kemi prapë problemin e njëjtë. Përsëri kanë për t'u tërhequr palët në pozitat e njëjta politike", ka theksuar Haziri.

Njohësi i zhvillimeve politike, Agon Maliqi, ka thënë për "REL" se edhe në rast se partitë politike i përgjigjen një ftese eventuale të Lidhjes Demokratike të Kosovës për bisedime në një tryezë, vështirë se aty do të mund të ndërrohen qëndrimet aktuale të tyre. Sipas tij, qëndrimet e AAK-së, të PDK-së, por edhe të Lëvizjes Vetëvendosje janë dhënë në formë ultimatumi dhe tashmë ato vështirë se mund të tërhiqen nga qëndrimet e tyre për shkak se "do të binin në pozitë të keqe". Siç thotë Maliqi, partitë politike tashmë vetëm se do t'i peshojnë vendimet e tyre, përllogaritjet e tyre të rezultateve të mundshme zgjedhore dhe ekuacioneve pas zgjedhjeve. "Përshtypja ime është që Ramush Haradinaj, ne e kemi parë dhe ky është tipar konsistent i tij kur ngul këmbë për diçka, atëherë nuk tërhiqet. Ndërkohë, unë nuk shoh interes as te LDK-ja dhe as te PDK-ja për t'ia mundësuar Haradinajt presidencën. Kështu që, në këtë kontekst, probabilitetin e vlerësoj diku te 80 për qind se do të shkojmë në zgjedhje, si dhe ndonjë mundësi e vogël apo ndonjë zgjidhje kreative në fund, e të cilën në këtë moment nuk po e shohim", ka thënë Maliqi.

Megjithatë, analisti Maliqi vlerëson se edhe pas zgjedhjeve të parakohshme eventuale, nuk do të arrihet një zgjidhje që mund ta sqarojë situatën lidhur me zgjedhjen e presidentit të ri. "Aty do të futemi në krizë edhe më të thellë për shkak të afateve kohore dhe për shkak të një konstelacioni të Kuvendit, ku konsensusi nuk mund ta shmangë Vetëvendosjen. Por, besoj se aty do të futemi në një situatë krejtësisht të re. Besoj se këtë gjë e kanë parasysh palët që janë tani duke negociuar. Por, po shihet që këto mund të jenë mbase zgjedhjet e para pa vija të kuqe dhe palët po kalkulojnë politikisht, në njëfarë forme, edhe me mundësinë e bashkëpunimit me Vetëvendosjen. Megjithatë, besoj se secila prej tyre do të dëshironte që ta shmangte", ka thënë Maliqi.

# Osmani qëndron për vizitë zyrtare treditore në Shqipëri

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 15 dhjetor-** Ushtruesja e detyrës e presidentit të Republikës së Kosovës, njëherësh kryetare e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, nga data 16-18 dhjetor do të qëndrojë në Shqipëri, në vizitën e parë zyrtare prejse e ka marrë detyrën. Gjatë qëndrimit në Shqipëri, u. d. presidentja e Republikës së Kosovës, Osmani, do të zhvillojë një sërë takimesh. Sot (e mërkurë), në orën 13:30, u. d. presidentja do të bëjë nderime te memoriali i Gjergj Kastriot Skënderbeut në qytetin e Lezhës, kurse në orën 15:30 u. d. presidentja do të pritet me ceremoni shtetërore nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ndërsa në orën 17:00 do të mbajnë konferencë të përbashkët për media.

Të enjten (17 dhjetor), në orën 09:30, u. d. presidentja Osmani do të takohet me kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi. (Vendi: Zyra e kryetarit të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit përballë godinës së Kryeministrisë).

Ndërsa në orën 10:15 u. d. presidentja do të bëjë nderime dhe të vendosë kurorë me lule te Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Ndërkaq, në orën 12:30, u. d. presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani, do të mbajë fjalim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në orën 16:00 Osmani do të takohet me kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama.

Të premten (18 dhjetor), në orën 10:00, u. d. presidentja Osmani do të takohet me kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha.

Ndërkaq, në orën 11:00, në Bashkinë e Tiranës, do të takohet me kryebashkiakun Erion Veliaj, ku do të mbahet edhe ceremonia e dorëzimit të Çelësit të Qytetit.

Kurse në orën 11:45 u. d. presidentja Osmani do të ketë takim me ish-presidentin e Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.






REPUBLIKA E KOSOVËS PËRBALLË PANDEMISË COVID-19

# 293 PJESËTARË TË POLICISË TË INFEKTUAR ME COVID

**Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka bërë me dije të martën se janë 293 pjesëtarë të policisë të infektuar me Covid-19, ndërsa në izolim janë 234 policë. Ai ka treguar se 12 policë kanë vdekur si pasojë e këtij virusi. Mehmeti ka thënë se vendimet e Qeverisë së Kosovës janë duke u respektuar nga ana Policia e Kosovës. Të martën ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka raportuar në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me menaxhimin e situatës me Covid-19, me ç'rast ka theksuar se shqetësuese mbetet numri i rasteve të të vdekurve. Vetëm gjatë 24 orë të fundit si pasojë e këtij virusi kanë vdekur edhe 17 persona**

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka raportuar të martën në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Ai ka raportuar lidhur me zhvillimet e fundit në Policinë e Kosovës si dhe për të gjeturat e raportit për vendin, për vitin 2020 të Komisionit Evropian.

Mehmeti ka shpalosur në komision detaje të aktiviteteve të Policisë së Kosovës gjatë këtij viti, duke treguar se numri i vrasjeve në Kosovë ka shënuar ngritje si dhe numri i rasteve të dhunës në familje. Përkitazi me dhunën në familje, një shqetësim që u ngreh nga anëtarët e komisionit, Mehmeti ka theksuar se pandemia ka qenë një ndër shkaktarët kryesor të rritjes së këtyre rasteve. Ndërkaq sa i përket çështjes së aksidenteve në komunikacion, ai tha se është shënuar një rënie krahasuar me vitin paraprak.

Pas këtij raportimi, anëtarët e komisionit kërkuan sqarime të shumta nga Mehmeti. Me theks të veçantë u kërkuan të dhëna lidhur me numrin e policëve të infektuar nga pandemia Covid-19, për dhunën në familje, për vjedhjet, për pagesën e orëve shtesë të zyrtarëve policorë, për çështjen e refugjatëve, për suspendimet dhe transferimet e policëve, për gjobat lidhur me mosrespektimin e masave anti-Covid, për çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për një varg çështjesh të tjera që ndërlidhen me këtë institucion.

Sipas Mehmetit, vendimet e Qeverisë së Kosovës janë duke u respektuar nga ana e Policisë së Kosovës, ndërsa sqaroi se aktualisht janë 293 pjesëtarë të policisë të infektuar me Covid-19, ndërsa në izolim janë 234 policë. Ai bëri me dije se 12 policë kanë vdekur si pasojë e këtij virusi.

## Edhe 17 të vdekur nga Covidi për 24 orë në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 035 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 294 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 17 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë katër raste (87, 86, 71, 61 vjeç), Gjilan tri raste (66, 66, 61 vjeç), Gjakovë dy raste (72, 72 vjeç), Rahovec dy rast (72, 71 vjeç), Istog një rast (72 vjeç), Lipjan një rast (64 vjeç), Podujevë një rast (68 vjeç), Prizren një rast (64 vjeç), Suharekë një rast (82 vjeç), Vushtrri një rast (70 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 47 203 raste nga 165 583 persona të dyshimtë me ketë virus dhe 1 220 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 482 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 34 637 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 346. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 149 raste, Pejë 20 raste, Drenas 19 raste, Podujevë 17 raste, Gjakovë 16 raste, Lipjan 16 raste, Mitrovicë 15 raste, Ferizaj 11 raste, Fushë-Kosovë 11 raste, Obiliq 8 raste, Istog 6 raste, Klinë 5 raste, Malishevë 5 raste, Rahovec 5 raste, Vushtrri 5 raste, Gjilan 4 raste, Prizren 4 raste, Suharekë 4 raste, Deçan 3 raste, Dragash 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Graçanicë dhe Skenderaj.

## Zemaj paralajmëron masa të reja

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, të martën ka takuar Bordin Këshillëdhënës, me anëtarët e të cilit kanë bërë vlerësime të situatës epidemiologjike dhe kanë nxjerrë përvoja se si të ecin më tutje. "Rekomandimet e dala nga takimet e Bordit, për Ministrinë e Shëndetësisë, kanë qenë udhërrëfyes për vendime. Gjatë takimit të sotëm diskutuam për situatën epidemiologjike, u dhanë vlerësime dhe propozime se si të reagohet në ditët në vijim, për të menaxhuar dhe parandaluar përhapjen e virusit", ka thënë Zemaj pas takimit. Po ashtu, Zemaj të martën ka takuar drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, dr. Bukurie Zhubi dhe me prof. dr. Sali Ahmetin, kryesues i grupit punues për hartimin e protokollit për përdorimin e plazmës konvaleshente, diskutuan për nevojën e finalizimit sa më të shpejtë të këtij protokolli. Në këtë takim u tha se trajtimi me

→




plazmë të personave të shëruar nga Covid-19 është hap përpara për trajtimin gjithëpërfshirës të infeksionit me Covid-19.
Drejtoresha dr. Bukurije Zhubi ka konfirmuar se Transfuzioni është i gatshëm dhe i përgatitur që t'i trajtojë pacientët që kanë nevojë për këtë terapi.
Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, gjatë ditës së martë ka raportuar para Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për menaxhimin e situatës me Covid-19. Ai ka thënë rënia e rasteve me Covid ka ardhur për shkak të masave të cilat janë ndërmarrë. Zemaj ka bërë me dije se masat e reja do të ndërmerren varësisht nga numri i të infektuarve në vend, ndërsa shqetësues e ka quajtur numrin e lartë të vdekjeve. "Me trendin e tanishëm të rasteve pozitive dhe ngarkesën e spitaleve dhe QKUK-së nënkuptohet se do të jenë në fuqi masat e ndërmarra në nëntor. Situata analizohet dhe varësisht nga projeksionet që kemi bërë në dy javët e fundit, kemi stagnim të virusit. Masat duhet të vazhdojnë për të ndikuar në ulje të lakores së infektimit. Shqetësues është numri i rasteve të të vdekurve. Kemi rënie të rasteve pozitive më pak se 15 për qind", ka thënë ai.
Ministri Zemaj ka folur për vaksinën kudër Covidit. Ai ka bërë me dije se më 7 dhjetor ka nënshkruar aplikimin për vaksinë, ndërsa ka treguar se Kosova është në mesin e 92 vendeve që 20 për qind të vaksinës do ta ketë falas.




# Ambasadorët amerikanë mbështesin prokurorët e Kosovës për krime të luftës

**Prishtinë, 15 dhjetor (ER)** - Ambasadori i përgjithshëm për Zyrën e Drejtësisë Penale Globale, Morse H. Tan dhe ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, janë takuar më 14 dhjetor me kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe me prokurorët nga Departamenti i Krimeve të Luftës në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), përfshirë edhe shefin Blerim Isufaj.
Të dy ambasadorët kanë ritheksuar zotimin e Shteteve të Bashkuara për t'i sjellë të gjithë kriminelët e luftës para drejtësisë, pavarësisht prej kombësisë së tyre.
Ambasadori Kosnett ka thënë se "përgjigjja ndaj padrejtësisë është më shumë drejtësi".
Ndërsa ambasadori Tan ka folur në lidhje me sfidat shqetësuese me të cilat përballet PSRK-ja për përmbushjen e këtyre çështjeve të rëndësishme.



Gjatë takimit prokuroria kishte mundësinë t'u drejtohej ambasadorëve dhe t'i njoftonte ata me disa prej sfidave me të cilat përballen.
Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i ka informuar ambasadorët se për disa zyra e tij kishte ndërmarrë hapa thelbësorë. Ai ka thënë se PSRK-ja ka trashëguar më shumë se 900 raste të papërfunduara nga EULEX-i dhe se janë dashur më shumë resurse për të lëvizur para.
Ndërsa Blerim Isufaj i ka informuar të pranishmit se mungesa e koordinimit me Serbinë dhe paaftësia për t'iu bashkuar Interpol-it dhe grupeve të tjera ndërkombëtare, paraqitën pengesë në punën e tyre.
Në fund, zëvendësshefi Valdet Gashi ka folur për 19 aktakuzat që zyra e tij kishte ngritur që nga viti 2018, dhe një rast i cili arriti deri në gjykimin përfundimtar.
Zyra e Drejtësisë Penale Globale dhe Ambasada Amerikane u zotuan për mbështetje shtesë për Departamentin e Krimeve të Luftës.

# Në Podujevë, pandemia, e menaxhueshme

PODUJEVË, 15 DHJETOR (ER) - Shtabi Emergjent i Komunës së Podujevës për veprime dhe masa parandaluese dhe mbrojtëse nga Covid-19 ka mbajtur takim, në të cilin është shqyrtuar gjendja aktuale me pandeminë dhe respektimi i masave mbrojtëse. Në takimin e Shtabit Emergjent, kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, u informua nga bartësit e sektorëve lidhur me gjendjen aktuale epidemiologjike në komunë dhe ka kërkuar veprime dhe ndërmarrje të masave të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Bulliqi ka bërë me dije se që nga marrja e mandatit të kryetarit ka qenë vazhdimisht në kontakt me stafin udhëheqës të QKMF-së, veçmas me epidemiologen Bedrie Rama, për ta përcjellë situatën me pandeminë. Ai ka thënë se janë duke u ndërmarrë masat që të zgjerohet hapësira dhe të shtohet numri i shtretërve në Qendrën për Trajtimin e Pacientëve me Covid-19 në QKMF, ku tashmë pacientët mund të marrin edhe oksigjenoterapi.

Bulliqi ka kërkuar që të sigurohen mjete mbrojtëse për shkollat dhe gjithashtu të bëhen investime për përmirësimin e kushteve higjienike. Lidhur me gjendjen me pandeminë Covid-19,



epidemiologia Bedrie Rama, ka thënë se situata është e menaxhueshme, përkundër faktit se në këtë komunë vazhdon të ketë numër të madh të rasteve me Covid-19.

# Fshati Gjonaj i Prizrenit tash e tutje do të ketë 24 orë ujë të pijshëm

PRIZREN, 15 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me banorët e fshatit Gjonaj dhe drejtorin e Shërbimeve Publike, Osman Krasniqi, kanë bërë përurimin e sistemit të ri të ujësjellësit në këtë fshat, i cili do t'u mundësojë banorëve 24 orë qasje në ujë të pijshëm. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se banorët e fshatit Gjonaj me vite të tëra janë ballafaquar me problemin e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërkaq këtë problem të kamotshëm ka arritur që ta zgjidhë gjatë qeverisjes ashtu edhe siç u kishte premtuar.

Ndërkaq drejtori Krasniqi ka theksuar se gjatë punimeve që kanë zgjatur më shumë se një vit e gjysmë, është bërë ndërrimi i tërësishëm i të gjithë gypave të ujësjellësit dhe është bërë vendosja e orëve matëse në 800 puseta të ujit.



# Komuna e Klinës ka furnizuar me mjete anti-Covid të gjitha shkollat

KLINË, 15 DHJETOR (ER) - Drejtori i Arsimit në Komunën e Klinës, Enver Gashi, bashkë me zyrtarët e arsimit, ka mbajtur takim me drejtorë të shkollave të kësaj komune, ku është diskutuar lidhur me vështirësitë që kanë pasur ata gjatë këtij viti mësimor. Drejtori Gashi ka theksuar se, duke pasur parasysh përhapjen e virusit Covid-19, Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Arsimit, ka qenë në koordinim të plotë me Ministrinë e Arsimit dhe të gjithë drejtorët e shkollave për ta përcjellë gjendjen dhe ka bërë furnizimet e nevojshme me mjete anti-Covid në të gjitha shkollat. Ai ka thënë se për shkak të situatës së krijuar janë shfaqur vështirësi për mbajtjen e procesit mësimor si dhe ka theksuar se DKA ka bërë zëvendësimet e mësimdhënësve të konfirmuar me Covid-19.

Ndërsa drejtorët e shkollave theksuan se gjatë kësaj periudhe kanë qenë të furnizuar në mënyrë të rregullt me mjete kundër përhapjes së virusit dhe kanë veçuar bashkëpunimin korrekt që kanë pasur me komunën, respektivisht DKA-në. Sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit, semestri i parë i këtij viti shkollor do të përfundojë më 18 dhjetor.




# Komuna e Malishevës ka filluar ndërtimin e stallave për bagëti

MALISHEVË, 14 DHJETOR (ER)- Në kuadër të realizimit të investimeve për subvencionimin e bujqve lokalë, përkatësisht në sektorin e blegtorisë, ka filluar zbatimi i këtij projekti, për fillimin e ndërtimit të stallës për bagëti të imëta, përkatësisht të dhive.

Rexhep Berisha nga Gurbardhi është fermeri me numrin më të madh të dhive.

Në fillimin e punimeve ishin të pranishëm nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, të shoqëruar edhe nga kryetari i fshatit, Bashkim Berisha.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, e ka uruar fermerin për ndërtimin e fermës. "Në emër të kryetarit të komunës dhe në emër të qeverisë komunale në Malishevë ju uroj për këtë fermë. Ne si qeveri komunale jemi të përkushtuar për përkrahjen e fermerëve, përkatësisht në fushën e bujqësisë dhe të blegtorisë, si degë e fuqishme ekonomike dhe, si në vitet e tjera, do ta vazhdojmë përkrahjen në këtë sektor. Ju e gëzofshi këtë stallë dhe uroj që ta rrisni fondin e dhive në mënyrë që sa më shumë të kemi në treg produkte të prodhimeve vendore", ka thënë nënkryetari Berisha.

Drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, si bartës i realizimit të ndërtimit të stallave, ka bërë me dije se kjo është një



prej stallave, pronarët e të cilave janë përfitues të shpalljes për subvencionim përmes bashkëfinancimit. "Ndërtimi i stallës ka një shumë prej 17 mijë eurosh dhe është bashkëfinancim. Komuna financon 70 për qind të projektit, ndërsa pronari 30 për qind", ka sqaruar Morina.

Pronari Rexhep Berisha e ka falënderuar komunën për këtë përkrahje, pasi do ta ndihmojë shumë për realizmin e planifikimit të tij për zgjerimin e fondit të dhive, por i ka munguar një stallë e tillë me standarde.

# Nasim Haradinaj të premten paraqitet para Speciales



**Prishtinë, 15 dhjetor (ER)** - Paraqitja e Nasim Haradinajt në Hagë është shtyrë për 18 dhjetor në orën 14:00. Lajmi është bërë me dije nga Dhomat e Specializuara. Pas konfirmimit të aktakuzës, Nasim Haradinaj ishte paraparë të paraqitet të martën para Speciales në orën 15:00. Në aktakuzën e konfirmuar, Nasim Haradinaj akuzohet për kryerjen e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë për kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. Avokati Tomë Gashi ka thënë se Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati nga data 25 shtator 2020 deri më sot e kanë konsideruar veten të kidnapuar nga Gjykata Speciale. Ai ka treguar se aktakuza kundër tyre përmban katër pika, të cilat, sipas Prokurorisë Speciale në Hagë, kanë të bëjnë me pengim të drejtësisë, e me akuza konkrete që, sipas saj, ndërlidhen me periudhën kohore në mes të datave 7 deri 25 shtator të këtij viti. "Kryetari dhe nënkryetari i OVL të UÇK-së dhe unë në cilësinë e avokatit të OVL të UÇK-së nuk e pranojmë këtë gjykatë njëetnike, raciste, tepër e dëmshme për kombin tonë shqiptar dhe për shtetin e pavarur të Kosovës", ka thënë avokati Gashi në një deklaratë për media.

# Naim Fetahu jep dorëheqje nga pozita e kryetarit të Degës së PDK-së në Podujevë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Podujevë, 15 dhjetor** - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Podujevë, Naim Fetahu, ka dhënë dorëheqja nga kjo pozitë. Lajmin e ka bërë me dije vetë ai përmes një njoftimi në llogarinë e vet në "Facebook", ku ka treguar arsyet e dorëheqjes. "Po bëhen 30 vjet qëkur jam aktiv në jetën publike dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Me besimin tuaj dhe përkushtimin tim, që nga paslufta kam shërbyer në pozita të ndryshme, duke filluar nga themelues e kryetar i parë i Degës së PDK-së në Podujevë, deputet, zëvendësminister (në tri mandate), drejtor i ATK-së e disa pozita të tjera menaxheriale. Të gjitha këto përgjegjësi shtetërore dhe institucionale i kam falë përkrahjes suaj. Besimi që ju më dhatë më bëri çdoherë e më energjik, të jem më obligues ndaj jush, ndërsa vlerësimin se sa ia kam arritur të jem afër jush, do ta bëni më së miri ju dhe koha", ka thënë ai.




Ai ka folur edhe për garën e fundit për kryetar të Podujevës. "Në zgjedhjet e fundit hyra në garë për kryetar të komunës me qëllim që ta bëjmë ndryshimin në Podujevë, me dëshirën që Llapit dhe Gollakut t'ua kthejmë dinjitetin. Por qytetarët i dhanë dikujt tjetër këtë besim dhe të gjithë duhet ta respektojmë. Këto 30 vjet në shërbimin publik dhe në aktivitete politike kanë bërë që të mos jem afër familjes aq sa duhet, e sidomos afër fëmijëve të cilët më shumë se kurrë kanë nevojë të jem afër tyre. Prandaj sot kam vendosur për arsye personale të jap dorëheqje nga pozita drejtuese në Degën e Partisë Demokratike në Podujevë. Kam vendosur që për një periudhë t'i kthehem familjes. Kjo nuk do të thotë se unë heqë dorë nga politika. Deri në frymëmarrjen e fundit unë do të jem në shërbimin tuaj sepse u jam borxhli për përkrahjen që ma keni dhënë ndër vite", ka thënë Fetahu. Ndërkaq kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka falënderuar Naim Fetahun për punën e bërë deri më tani në krye të degës së kësaj partie në Podujevë.

# Kazakistani nderon Pacollin me çmimin më të lartë shtetëror



**Prishtinë, 15 dhjetor (ER)**- Me rastin e përvjetorit të pavarësisë së Kazakistanit, në kryeqytetin Nur-Sulltan, kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), deputeti Behgjet Pacolli, është nderuar nga presidenti i këtij vendi me çmimin më të lartë shtetëror. "Duke falënderuar bashkëpunëtorët, inxhinierët dhe stafin drejtues të kompanisë 'Mabetex' për punën e shkëlqyer dhe respektin për të tjerët, pata nderin të nderohem me çmimin më të lartë shtetëror për kontributin tonë dhënë në zhvillimin modern të këtij vendi. Është nder i madh për mua dhe kompaninë time të nderohem nga presidenti Nazarbayev i cili konsiderohet babai i kombit kazak. Nga thellësia e zemrës sime falënderoj të gjithë ata që më uruan për këtë ngjarje. Ju priftë e mbara!", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

## Hoxhaj takon strukturat e PDK-së në Pejë dhe në Deçan

**Pejë, 15 dhjetor (ER)** - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka vizituar kryesitë e degëve të PDK-së në Pejë dhe në Deçan.
Zhvillimet e fundit politike, përfshirë miratimin e Ligjimit për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili u votua me masat e propozuara të PDK-së, ishin temë e diskutimit.
Hoxhaj foli edhe për themeluesit e UÇK-së dhe liderët e shtetit që po mbahen padrejtësisht në Hagë. Ai ka thënë se që të gjithë do të dëshmojnë edhe një herë pastërtinë e luftës çlirimtare të Kosovës.
Kryesitë e këtyre dy degëve kanë përgëzuar kryesinë qendrore të PDK-së për masat e propozuara dhe më pas votimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ndërkaq sa iu përket të gjitha zhvillimeve politike në vend, të dy kryesitë i kanë dhënë mbështetjen e plotë kryetarit në detyrë, Hoxhaj dhe kryesisë së Partisë



# Gastronomët kërkojnë zgjatjen e orarit për bizneset



PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës (ShGK) i ka bërë thirrje qeverisë t'ua zgjasë orarin e funksionimit bizneseve.

ShGK-ja ka theksuar se shteti ka pasur disa tentativa modeste që të ndikojë në ekonomi si rrjedhojë e situatës së krijuar me pandeminë por, sipas kësaj shoqate, këto tentativa ishin të pasuksesshme. "Që nga marsi e deri më tani shëndeti publik dhe ekonomia e vendit tonë është goditur nga pandemia dhe masat e vendosura nga institucionet publike. I kemi pasur disa tentativa modeste për të ndikuar në ekonomi nga ana e shtetit por, fatkeqësisht, të pasuksesshme. Sa më shumë kohë që nuk jemi përkrahur ekonomikisht, dëmet janë përshkallëzuar edhe më shumë. Duke marrë parasysh situatën dhe mosefektivitetin e masave, ne njëzëri edhe me odat dhe shoqatat e tjera sektoriale i bëjmë thirrje qeverisë që ta drejtojë fokusin drejt çështjeve ekonomike dhe ta ngrehë nivelin e dialogut publiko-privat. Rrjedhimisht, e konsiderojmë të domosdoshme zgjatjen e orarit të funksionimit të bizneseve në të gjitha komunat në mënyrë që të mundësohet operimi normal i bizneseve, gjithmonë duke marrë parasysh rekomandimet e OBSh-së", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.

Sipas ShGK-së, po të lejohen bizneset të veprojnë në rrethana normale (pa kufizime kohore), 45 për qind e bizneseve kanë raportuar se u duhen më shumë se një vit për t'u rikuperuar, ndërsa 43 për qind prej tyre janë shprehur se u duhen 3 deri në 12 muaj që të kthehen në gjendje normale të funksionimit. "Për këto arsye, zgjatja e orarit pashmangshmërisht duhet të ndodhë", është thënë në reagimin e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.

# 75 për qind e të hyrave të Postës shpenzohen për paga

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ



PRISHTINË, 16 DHJETOR- Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2019 për Postën e Kosovës. Të ftuar në këtë raportim ishin kryesuesi i Bordit, Leonard Shabanaj dhe kryeshefi ekzekutiv i Postës, Xhevdet Smakiqi.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosjes, Arta Bajralija, ka thënë se gjendja financiare në Postë është jo e mirë. Ajo ka lexuar një varg shkeljesh të gjetura nga Zyra e Auditorit. "Ndërmarrjet publike në përgjithësi, ashtu edhe Posta, kanë një gjendje jo të mirë financiare. Gjendja jo e mirë ka ardhur për shkak të joseriozitetit si dhe keqmenaxhimit të aseteve të Postës. Edhe në vitin 2018 dhe 2019 Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar se pasqyrat financiare nuk paraqesin pamje të vërtetë të gjendjes financiare të Postës. Përveç që Posta nuk mbulon shpenzimet e veta, ndërmarrja është thelluar edhe në borxhe të tjera. Nga 1 022 punëtorë sa ka Posta, mbi 9 milionë euro shkojnë për paga, që do të thotë se 75 për qind e të hyrave shpenzohen vetëm për paga", ka thënë ajo.

Bajralija ka theksuar se, sipas të gjeturave të Auditorit, zyrtarë që punojnë në Postën e Mitrovicës janë nënshkruar në listat e vijueshmërisë kur e kanë përfunduar orarin, por vetëm në fillim të punës. "Gjithashtu, 11 drejtorë në zyrën qendrore të kompanisë nuk ishin nënshkruar në listat e vijueshmërisë fare ose janë nënshkruar vetëm në fillim të punës. Mosvijueshmëria e rregullt e rrit rrezikun për mosangazhim të plotë", ka thënë ajo.

Ndërkaq kryesuesi i Bordit të Postës së Kosovës, Leonard Shabanaj, ka thënë se humbjet milionëshe në këtë ndërmarrje janë evidente, derisa është ankuar për gjendjen në të cilën ndodhen objektet e Postës.

Ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv në këtë ndërmarrje, Xhevdet Smakiqi, ka thënë se kanë marrë masa për t'i adresuar gjetjet e ZKA-së për vitin 2019. "Bordi dhe menaxhmenti ka ndërmarrë masa menjëherë për zbatimin e rekomandimeve. Disa janë zbatuar, disa janë në proces", ka thënë Smakiqi.

Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Bedri Hamza, ka thënë se është shqetësues numri i madh i rekomandimeve për vitin 2019 dhe gjendja në të gjitha ndërmarrjet publike. Hamza ka kërkuar që sa më shpejt qeveria ta emërojë bordin e drejtorëve në mënyrë që pastaj të bëhet emërimi i kryeshefit ekzekutiv. Sipas tij, mbajtja e pozitave me borde të përkohshme dhe me ushtrues detyre nuk mund ta ndryshojë gjendjen aktuale në këtë ndërmarrje publike.

Ndërsa deputetja e LDK-së, Besa Gaxherri, ka thënë se gjendja është më e keqe sesa që është paraqitur në raportin e auditimit.

# Krasniqi viziton Zonën Ekonomike të Vitisë, priten të vendosen rreth 40 biznese

VITI, 15 DHJETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka vizituar të martën Zonën Ekonomike në Budrikë të Vitisë, për t'i parë nga afër punimet që po bëhen për ta finalizuar këtë projekt të rëndësishëm ekonomik për këtë komunë. Ai ka thënë se në bazë të projektit, këtu parashihen të vendosen rreth 40 biznese të fushave dhe veprimtarive të ndryshme. "U pajtuam që menjëherë, pas finalizimit kësaj zone ekonomike, t'i shtohen edhe disa hektarë për ta rritur hapësirën e saj dhe për t'iu mundësuar qasje dhe hapësirë edhe bizneseve të Gjilanit dhe Luginës së Preshevës, që të investojnë në këtë zonë", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas dinamikës së punës, ai ka bërë me dije se në fillim të pranverës së vitit të ardhshëm priten të vendosen bizneset e para. Këtë projekt e ka financuar MTI-ja dhe kap vlerën 1.8 milion euro.



# 850 fermerë pritet të përfitojnë grante në vlerë prej 29 milionë eurosh

Të martën janë nënshkruar kontratat e para të përfituesve të granteve nga Programi për Zhvillim Rural 2020-21. Rreth 850 fermerë pritet të përfitojnë grante në vlerë prej 29 milionë eurosh. Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se, pavarësisht prej situatës së vështirë dhe problemeve ekonomike që ka sjellë pandemia Covid-19 edhe në buxhetin e shtetit, bujqësia po e merr vëmendjen e duhur




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 DHJETOR- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka nënshkruar kontratat e para të përfituesve të Programit për Zhvillim Rural 2020-21. Rreth 850 fermerë pritet të përfitojnë grante në vlerë prej 29 milionë eurosh.

Në ceremoninë solemne të nënshkrimit të gjashtë kontratave të para ishte i pranishëm edhe kryeministri i Avdullah Hoti, i cili ka deklaruar se bujqësia po merr vëmendjen e plotë gjatë qeverisjes së tij. Sipas Hotit, bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm për ta rritur prodhimin vendor, aftësinë konkurruese të ekonomisë vendore, për ta përmirësuar bilancin tregtar si dhe për ta ulur importin e madh të produkteve bujqësore. “Besoj se është bërë një punë e madhe dhe e mira e kësaj është se, pavarësisht prej situatës së vështirë nëpër të cilën po kalojmë me pandemi, me problemet ekonomike që na ka sjellë kjo pandemi edhe në buxhetin e shtetit, prapë bujqësia po e merr vëmendjen e plotë që duhet të ketë. Përtej kësaj, me Fondin për Rimëkëmbje Ekonomike, janë dyfishuar subvencionet në pjesën e bujqësisë, prej të cilave pjesa më e madhe do të arrihet të paguhet brenda këtij viti. Bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm për të ardhurat e familjeve, për punësimin në Kosovë e, mbi të gjitha, për ta rritur prodhimin vendor, aftësinë konkurruese të ekonomisë vendore, për ta përmirësuar bilancin tregtar si dhe për ta ulur importin e madh të produkteve bujqësore që kemi”, ka deklaruar Hoti, duke shtuar se po punojnë për kompletimin e infrastrukturës ligjore për ta mbështetur bujqësinë. “Po përpiqemi ta kompletojmë infrastrukturën ligjore edhe përmes instrumenteve të ndryshme, ta mbështesim bujqësinë. Dje patëm një diskutim të gjatë me Fondin për Garantim të Kredive, ku do të ketë dritare të veçantë për kreditim në kushte të volitshme edhe me mbulim të kolateralit deri në 80 për qind për kredi që lëshohen në fushën e bujqësisë. Fondi për Garantim të Kredive shumë shpejtë do t’i përmbyllë të gjitha procedurat e nevojshme në mënyrë që bujqit të fillojnë menjëherë të përfitojnë nga kjo masë, bazuar në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike që tanimë ka kaluar në Kuvend”, ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se një fushë tjetër e rëndësishme të cilën ministri Mustafa me pasion e ka kryer gjatë këtij viti është masterplani për ujitjen e tokave bujqësore. “Një plan që mbulon gjithë vendin dhe që besoj për pesë vjet do ta ndërrojë komplet prodhimin në bujqësi, duke e shumëfishuar tokën bujqësore që është nën ujitje. Ka plot donatorë që janë duke e mbështetur këtë fushë dhe ministri është duke bërë një punë të mirë për koordinimin e të gjithë mbështetjes që vjen në fushën e bujqësisë. Jemi duke i dhënë vëmendjen e duhur edhe në buxhetin e vitit 2021, edhe në Strategjinë Kombëtare 10-vjeçare, por edhe në pjesën e Programit të Rregullt të Mbështetjes që marrim nga Komisioni Evropian përmes IPA-së”, ka deklaruar Hoti.

Kurse ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, u ka premtuar mbështetje bujqve, derisa tha se në këtë periudhë të pandemisë kanë dyfishuar subvencionet karshi tyre. “Falë punës sonë për krijimin e kushteve dhe kritereve të barabarta për bujqit dhe rritjen e transparencës për ndarjen e këtyre granteve kemi arritur të përfitojmë edhe 5 milionë euro nga BE-ja për t’u ndarë grante bujqve tanë për ta lehtësuar tejkalimin e Covidit. Së shpejti do të shpallim edhe thirrjen e dytë për aplikim për grante nga programi për zhvillim rural 2020-2021. Presim të kemi 850 përfitues të granteve në vlerë prej 29 milionë eurosh nga Ministria e Bujqësisë, të cilat do të krijonin 2 500 vende të reja të punës. E tëra kjo do të ndodhë deri në dhjetor të vitit 2021. Sot thirrja e parë për grante u bë me nënshkrimin ceremonial të këtyre 6 kontratave e nga sot vazhdon nënshkrimi i qindra kontratave deri në dhjetor të vitit 2021”, ka deklaruar ministri Mustafa.

# Sektori i industrisë përpunuese shënoi rritje 57.38 për qind

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER)- Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat afatshkurtra të industrisë, duke paraqitur indeksin e vëllimit industrial për TM3 2020 (2017=100). Sipas ASK-së, kjo anketë me të dhënat që ofron, synon ta paraqesë ecurinë në industri: B - Nxjerrëse, C - Përpunuese, D - Furnizim me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, dhe E - Furnizim me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave, në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit në industri. Në tremujorin e tretë (TM3) 2020, krahasuar me tremujorin e dytë (TM2) 2020, ka pasur rritje në sektorin e: industrisë përpunuese (C) me 57.38 për qind dhe të furnizimit me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) 15.66 për qind”, është thënë në raportin e ASK-së, duke bërë me dije, po ashtu, se ulje kishte në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe të furnizimit me rrymë, gaz dhe avull. “Ulje kishte në sektorin e industrisë nxjerrëse (B) për (-41.46 për qind) dhe në sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) për (-9.90 për qind). Sipas ASK-së, krahasuar TM3 2020 me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM3 2019), ka pasur rritje në sektorin e industrisë përpunuese (C) 13.21 për qind, kurse ulje kishte në: sektorin e industrisë nxjerrëse



(B) për (-45.48 për qind); sektorin e furnizimit me ujë, veprimtarisë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (E) për (-38.75 për qind) dhe në sektorin e furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D) për (-7.12 për qind).



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

# ZGJEDHJET E JASHTEZAKONSHME DO TË PROVOKOJNË ZGJEDHJE TË TJERA TË JASHTËZAKONSHME

**Gjykata Speciale Raciste e rrëzoi presidentin, ajo edhe do ta zgjedhë presidentin tjetër**: Kosova është në krizë të thellë, tash edhe për shkak të pandemisë. Edhe më parë kishim krizë ekonomike dhe politike, nëpër kriza të tilla po lindim, po rritemi dhe po vdesim. Realisht, kriza më e rëndë që e ka kapluar Kosovën është kriza morale, mungesa elementare e moralit njerëzor dhe politik. Që nga koha e paraluftës e deri më sot, zgjedhja dhe posti i presidentit ishte mollë sherri dhe monedhë për veprime më të pamoralshme të individëve të caktuar dhe grupimeve politike apo klaneve të interesit. Në fillim të viteve '90, Ibrahim Rugova ishte zgjedhur president i një shteti që, as nuk kishte subjektivitet juridik dhe as ndërkombëtar, përjashtuar këtu Republikën e Mashedezekut që, nga zyrat e LDK-së, me një fax-telegram e pranoi Republikën e Kosovës dhe, për pasojë, edhe Ibrahim Rugovën president. Rugova kishte përkrahje të plotë të pjesës dërrmuese të qytetarëve të Kosovës, madje edhe të të burgosurve politikë shqiptarë në saje të sugjerimeve të Bacës Adem Demaçi. Po të bënte një rezistencë të vërtetë Ibrahim Rugova, Baca Adem kurrë nuk do ta kundërshtonte, por se do të ishte krahu i tij kryesor. Ibrahim Rugova, pas përfundimit të luftës, nuk u zgjodh president dhe nuk do të zgjidhej kurrë pa pëlqimin e PDK-së dhe të Hashim Thaçit. Në këtë mënyrë edhe u zgjodh, pas një kompromisi politik. Duhet të pranohet fakti se Ibrahim Rugova, ndonëse u zgjodh president, pas përfundimit të luftës të një shteti që nuk ishte pranuar si shtet (Kosova fitoi një pavarësi të mbikëqyrur në vitin 2008 kur Rugova kishte ndërruar jetë), ishte personaliteti më i votuar nga të gjithë presidentët, madje kishte më shumë vota se të gjithë bashkë, hiç këtu Hashim Thaçin. Ishte një paradoks kur njeriu më i votuar në Kosovë ishte president i një shteti që, në fakt, nuk ishte shtet sepse nuk ishte pranuar si shtet nga askush siç ishte Kosova, deri në shkurtin e vitit 2008. Pas vdekjes së Rugovës, aspirantin për postin e presidentit, Nexhat Daci, ndërkombëtarët jo që nuk e lejuan të bëhet president, por edhe e shkarkuan nga posti i kryetarit të Kuvendit për faktin se: "Pati kënduar kundër ndërkombëtarëve i pari dhe në kohë të gabuar" dhe, sipas një rregulli të pashkruar: "Këndezi që këndon para kohe, përfundon në tenxhere...". Ky ishte fati i Nexhat Dacit që pastaj të fillojë fatkeqësia e presidentëve që do të zgjidhen më vonë, në kundërshtim me çdo rregull dhe standard moral. Kjo nënkupton që për Dacin u bë shumë më mirë që nuk u zgjodh president, se këta që pastaj u zgjodhën presidentë, duke u lëvyrur skajshmërisht apo duke e blerë postin me shumë para. Dy presidentëve ua hoqi kokën presidenciale Gjykata Kushtetuese e Kosovës, njëra e përfundoi mandatin që nuk e kishte merituar me asgjë përveçse i ra tamam zarfit të një banditi të pamoralshëm e që, për fat të keq, rastisi të ishte ambasador në Kosovë. Ndërkaq, ish-presidentin e Kosovës i cili mandatin ceremonial e fuqizoi me mandat ekzekutiv sikur Kosova të ishte republikë presidenciale, Hashim Thaçin, e la pa kokë presidenciale Gjykata Speciale Raciste, kryeprokurori i së cilës, si kryeracist që është, nuk po mjaftohet me heqjen e kokës presidenciale të Hashim Thaçit, por po kërkon që Burgu në Hagë të bëhet vendi dhe varri ku Hashim Thaçi do ta lë kokën duke paralajmëruar se ish-presidenti i Kosovës mund të dënohet me burg të përjetshëm, që nënkupton se Hashim Thaçi nuk ka as gjasa teorike të dalë gjallë nga ky burg, sipas kërkesës së paskrupullt të një kryeprokurori edhe më të paskrupullt!

**Ramush Haradinaj, president i Kosovës, pse jo dhe pse po**: Një mik imi, avokat i zoti shumë, me të cilin e pi kafen e mëngjesit dhe ndahem shumë i kënaqur se mësoi shumë gjëra nga ai, sot në mëngjes më ngushtoi me pyetjen: "kryetar suprem i të drejtave të njeriut, dua të më përgjigjesh në një pyetje se kënd do ta përkrahje për president e që është jashtë politikes dhe kënd që është brenda politikës?" Bëra përpjekje ta dribloj avokatin duke i ikur përgjigjes, por kjo i ngjante përpjekjes që Zafir Berisha e driblon Mesin jo në fushën e kibernetikës ku edhe është Mesi vetë Zafiri, por në fushën e futbollit ku është vetëm Mesi dhe pas tij, përsëri është vetëm Mesi. Për kandidatin jashtë politikës, si kriter kisha integritetin moral dhe profesional si dhe karakterin unifikues që janë kushte për përkrahje më gjithëpërfshirëse. Të tillë sot nuk ka në Kosovë dhe nuk mund ta gjeni edhe nëse e fitoni Çmimin Nobel. Prandaj, e bëra një propozim në personalitetin e Enver Hasanit, ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe ish-Robespjerit (udhëheqësit të Revolucionit borgjez francez, dashamirë dhe praktikues efektiv i gijotinës), pasi i hoqi →

kokën presidenciale të Fatmir Sejdiut dhe kokën jopresidenciale të Behgjet Pacollit! E thashë këtë sipas stilit, pordha ime - propozimi im, ndonëse e kisha të qartë që ata që nuk e lejuan Enver Hasanin të bëhet Avokat i Popullit, nuk do ta lejojnë as të kalojë nga Zyra e Presidentit! Realisht, kandidati më i mirë për president nga jopolitikanët, po të pranonte e jam i sigurt se nuk pranon, do të ishte Luan Shllaku. Për asgjë tjetër, është ekspert për mbrojtje të ambientit dhe, do të ishte dora e Zotit për pastrim të ambientit skajshmërisht të kontaminuar në Kosovë, të të gjitha llojeve. Tash, sa i përket kandidatit me veshje politike dhe me post politik. Këtu fare nuk kam vendosur standarde, si kusht, madje as ato elementare. Isa Mustafa është deklaruar se nuk i takon ky post për faktin se LDK-ja e ka kryeministrin dhe, gjithashtu, edhe kryetaren e Kuvendit që ende deklarohet se është anëtare e LDK-së dhe se askush nuk do ta largojë nga LDK-ja. Lutfi Haziri nuk ka kohë të bëhet president shkaku se po kujdestaron te dera e LDK-së duke filtruar emrat që do ta kenë këtë post e që patjetër duhet të kalojnë nëpër zyrat e LDK-së. Albin Kurti nuk pranon të bëhet president sepse ky post për të është i vogël dhe ia heq mundësinë të shkarkojë Borde apo individë apo t'i arrestojë kundërshtarët politikë për korrupsion të lartë dhe tradhti ndaj shtetit siç ia rekomandon dega e Kominternës nga Tirana, e që janë në Prishtinë. Unë për veten time do të kandidoja për president po të kisha një emër tjetër dhe jo atë që e kam, Behxhet. Po të kandidoja për president do ta diksreditoja, padrejtësisht një president siç ishte Behgjeti prandaj, e pranoj, për shkak të pazotësisë të bëhem pjesë e çdo moçali apo kanalizimi, kam vendosur të mos kandidoj për president duke e respektuar dhe kujtuar emrin dhe veprën e pavdekshme, sidomos patriotike të Begjës! Fatmir Limaj, si kandidat për president nuk varet nga vota në Kuvendin e Kosovës sa nga një kartolinë nga Haga! Nehat Idrizi u vetëkandidua për president të Kosovës dhe, që në ditën e parë, me një enciklikë, urbi et orbi, si Papa i Vatikanit, iu drejtua të gjitha partive politike dhe popullit të Kosovës për përkrahje por se duket se adresat i ka pasur të gabuara! Tash, të ndalemi te PDK-ja që e kishte çelësin për zgjedhje të presidentit por se e luajti dhe po e luan lojën si të bëhej fjalë për zgjedhje të udhëheqësit të fisit Zulu në Afrikë! Sot, PDK-ja nuk ka lidership, ka kakofoni (shumë zëra, si në qëndrim ashtu edhe në shfaqje të mendimit)! Realisht, mendoj se PDK-ja do të duhej të ishte partia e fundit që do të insistonte për postin e presidentit. Pas Hashim Thaçit, çdo president nga radhët e PDK-së do të ishte karikaturë e presidentit ndërsa lidhja emocionale për postin e presidentit shkaku se këtë post e ka pasur Hashim Thaçi i cili tani është në qendrën e Paraburgimit në Hagë është arsyetim për budallenj dhe josinqeritet i madh. PDK-ja ka vetëm dy rrugë; nëse i përkrahë zgjedhjet e që nuk jam aspak i sigurt se është për zgjedhje, pa hezitim dhe pa asnjë kusht duhet ta nënshkruaj mocionin për mosbesim ndaj qeverisë Hoti. Dhe, e dyta, të bëhet pjesë e qeverisë Hoti, pa postin e presidentit por me ministri të fuqishme. Në këtë mënyrë do të krijohej një koalicion i gjerë që do ta kishte mandatin e plotë. Kjo qeveri do të kryente do punë për Albin Kurtin, si marrëveshja me Serbinë e që pastaj Albin Kurti, me shpatë në dorë, me bekimin dhe përkrahjen e ndërkombëtarëve do të prente kokat e korrupsionit. Natyrisht se ky kombinim do ta kishte çmimin e caktuar në zgjedhjet lokale, në fund të vitit të ardhshëm.

**Ramush Haradinaj president, pro et contra**: Ramush Haradinaj ishte dy herë kryeministër i Kosovës dhe nuk e përfundoi asnjë mandat. Në zgjedhjet e fundit ishte deputet i AAK-së por se hoqi dorë nga mandati. Këtë e bëri për faktin se e donte postin e presidentit. Pastaj doli haptas me këtë qëndrim kurse AAK-ja e kushtëzoi këtë post me fatin e qeverisë Hoti. Sidomos pasi Hashim Thaçi dha dorëheqje pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Raciste Speciale e Hagës. Duket se Ramushi ka biseduar, edhe me Hashimin sikur edhe me Kadrinë për këtë post të cilët, në bazë të informatave që i kam, as nuk ia kanë këputur shpresat për postin e presidentit, por as nuk i kanë garantuar 100 për qind se do ta përkrahin. Ramushi ka të drejtë kur thotë se bisedimet me Hashimin dhe Kadrinë për postin e presidentit kanë avancuar shumë. AAK-ja, nuk ka lënë asnjë hapësirë tjetër veç Ramushi president, ose shkuarja në zgjedhje. Me numrat e sotëm, presidenti nuk mund të zgjidhet, as si përpjekje pa votat e AAK-së (sigurimi i 80 deputetëve për votim të presidentit), qoftë edhe si përpjekje. AAK-ja është e vetëdijshme për këtë prandaj po e përdorë këtë xhoker në favor të Ramushit president. Dikush do të thotë se kjo është e pandershme, por më tregoni cili president, pas përfundimit të luftës në Kosovë u zgjodh në mënyrë të ndershme!! Aktualisht Ramush Haradinaj nuk ka pengesa ligjore të zgjidhet president i Kosovës dhe në këtë rrafsh çdo gjë është në rregull. Tash, flasim pak për kompetenca, meritokraci dhe moral politik. Posti i presidentit, pas Hashim Thaçit është kryesisht post ceremonial, me kompetenca të cunguara. Merreni Atifete Jahjagën, Begjën që kurrë as që ka qenë president sipas Gjykatës Kushtetuese dhe Fatmir Sejdiun. Nuk janë pyetur për asgjë dhe nuk kanë vendosur për asgjë! Është vështirë e besueshme se Ramush Haradinaj do ta pranonte këtë rol. Integritetin moral as që e kam vënë si kusht për postin e presidentit politik. Ndërkaq, sa i përket meritokracisë për çlirimin e vendit, Fatmiri, Fetja dhe Begja nuk kanë dhënë as 10 për qind sa ka dhënë Ramush Haradinaj. Ramushi e ka të qartë se partia nuk i rritet, pranimi i postit të ministrit për të do të ishte prapakthim në karrierë pasi dy herë ishte kryeministër ndërsa tani e ka mundësinë e artë të bëhet president, sipas vlerësimit të tij dhe të AAK-së dhe ta përmbyllë karrierën politike. Çdo politikan, i karrierës apo i shpifur do ta dëshironte këtë fund e që është e drejtë legjitime. Ramushi po thotë se ka informata se nuk është subjekt i Gjykatës Speciale Raciste. Mund të jetë e vërtetë por gjykatat për krime lufte shumë herë kanë marrë vendime gjyqësore për eliminime politike, në funksion të ndërtimit të paqes dhe pajtimit. Dhe, në fund të fundit, nëse qenkan bërë president Fatmiri, Begja dhe Fetja, pse nuk mund të bëhet president Ramush Haradinaj?! Tash, mendimi im, po të më pyeste Ramush Haradinaj, do të ishte që, edhe nëse e propozojnë për postin e presidentit, nuk do të duhej ta pranonte! Po, në fund të fundit kush jam unë të japë mendime për tema aq të mëdha!

**Çka sjellin zgjedhjet e jashtëzakonshme, mendoj asgjë**: LV-ja është shumë e interesuar për zgjedhje të jashtëzakonshme sepse mendon se është në Himalajen e popullaritetit. Mund të jetë edhe ashtu! Podujeva nuk mund të përdoret si model i suksesit për faktin se në Podujevë kanë garuar vetëm dy subjekte politike, LV-ja dhe LDK-ja kurse PDK-ja e ka pasur rolin e endacakut në këto zgjedhje. Në zgjedhjet eventuale të jashtëzakonshme garojnë, së paku 40 subjekte politike dhe vota shpërndahet. Të gjitha subjektet tjera politike i kanë frikë zgjedhjeve të jashtëzakonshme, si djalli - temjanit. Lëri deklaratat se janë të gatshme për zgjedhje. Po se situata është shumë serioze e kuptova kur AKR-ja doli botërisht se do ta përkrahë mocionin e LV-së për rrëzim të qeverisë Hoti. Parti kuislinge, pa asnjë dyshim. Edhe Lista Serbe është deklaruar pro mocionit për rrëzim të qeverisë Hoti ndërkaq PDK-ja, sipas një biseksualitetit politik, është edhe për (nëse nuk e kanë presidentin) edhe kundër (nëse e fitojnë presidentin). AAK-ja ka qëndrim të qartë. AAK-ja fajësohet se po e përdorë shantazhin për arritje të qëllimeve politike por, sipas bindjes sime këtë po e bënë edhe PDK-ja! LV-ja, ende po e vajton me mindil në duar humbjen e pushtetit dhe po kërkon dorëheqjen e qeverisë Hoti. Që po e quajnë ilegjitime e që nuk është aspak e vërtetë. Qeveria Hoti është plotësisht legjitime dhe nuk ka asnjë arsye të japë dorëheqje. Në kohë të pandemisë, edhe qeveritë më të fuqishme po kanë problem në udhëheqje e lëre më qeveria Hoti, të cilës ia kanë futur pykat sidomos për miratimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike.

Subjektet politike në Kosovë janë të pasinqerta. Po të ishin të sinqerta dhe po ta donin Kosovën dhe po të kishin edhe minimum respekti për qytetarët e Kosovës, do të bëheshin bashkë për ta përballuar më lehtë pandeminë sikur edhe bisedimet me Serbinë. Po të ishin bashkë, do ta kishin një marrëveshje më të përballueshme me Serbinë. Kështu, sa më shumë të zgjasin bisedimet dhe sa më të përçarë që jemi, oferta për Kosovën do të jetë shumë më e keqe dhe marrëveshja përfundimtare do të jetë më e dëmshme. Nëse nuk e duan bashkimin dhe bashkëpunimin e gjerë ndërpartiak dhe politik, atëherë duhet ta zgjedhin presidentin dhe të merren vesh për zgjedhje të reja, të parakohshme apo të jashtëzakonshme. Pse e them këtë?

LV-ja i fiton zgjedhjet e ardhshme, pa asnjë problem. Mirëpo jo me përqindje që e thotë. Në variantin më të keq, LDK-ja dhe PDK-ja nuk do të mbesin pa 42-45 deputetë e që në rastin konkret e përjashton konsensusin për zgjedhje të presidentit nëse LV-ja i ka vijat e kuqe ndaj PDK-së dhe LDK-së, nëse udhëhiqet nga Isa Mustafa. Pra, përsëri do të vinim në krizë e që do të provokonte zgjedhje të jashtëzakonshme. Po e them hipotetikisht, nëse subjektet politike, në ndërkohë nuk i ndryshojnë qëndrimet dhe nëse LV-ja do të preket nga daltonizmi (nuk e dallon ngjyrën e kuqe). AAK-ja do të sillet rreth 8-9 për qind të votave kurse Mimoza Kusari dhe Vjosa Osmani, me iniciativat e veta do të bëhen pjesë e listës zgjedhore të LV-së. Vjosa Osmani nuk po ngutet; po i pretë zhvillimet në LDK-së se çfarë erëra po fyejnë, mund të forcohet shumë dhe shpejtë nëse mbizotëron në LDK fryma e Haxhi Avdylit dhe Haxhi Qamilit!

Tash te LV-ja. Unë do të dëshiroja që LV-ja të fitojë, jo 61 deputetë por 81 dhe ta ketë pushtetin absolut. Vetëm atëherë do të kishte mundësi të bëjë punë të mëdha për Kosovën dhe popullin (shumë thirret në popull) ose, që unë e vlerësojë si reale, të dështojë krejtësisht duke u shndërruar në një autokraci. Realisht, LV-ja që unë e kam përkrahur dikur në çdo aspekt, tash e ka vetëm emrin. Patriotët e vërtetë që dikur i dhanë vulën LV-së, tash janë hirrëzuar, janë vendosur në margjina, nuk pyeten dhe nuk vendosin për asgjë dhe janë shndërruar në instrument për ekzekutim të vendimeve politike të një grupi të Kominternes në Tiranë sikur që shërbejnë si skuadër pushkatimi politik dhe kombëtar të një shtrese që hatashëm ka marrë poste në LVV e të cilët nuk kanë asnjë të kaluar kombëtare, janë pa integritet moral kurse profesionalizmin e kanë fituar në trajnime ku është folur kundër luftës dhe çdo gjëje kombëtare. Prandaj, jam fuqishëm që LV-ja të ketë pushtet absolut sepse, në atë rast nuk do të kishim një zgjidhje mesatare por, ose vërtetë do ta realizonim bashkimin kombëtar ose, varësinë që e kemi sot ndaj Serbisë do ta përligjnim me një marrëveshje bashkëpunimi me Serbinë, si koloni e ligjshme kurse Shqipërinë do ta përdornim për shpëlarje kombëtare, furnizim me pasaporta me viza Shengen apo shkuarje në det dhe kruarje me politikanë të Kominternes! Nëse ia huqi në parashikim, fajin kryesor e ka pandemia, jo unë!




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Vëllaznimi, për fitore edhe ndaj Rahovecit

Skuadra kuqezi e Vëllaznimit, pas fitores ndaj Prishtinës dhe Pejës, synon të fitojë edhe në ndeshjen ndaj Rahovecit, e cila zhvillohet sot (e mërkurë) në Gjakovë. Sot zhvillohet edhe përballja tjetër në mes të Golden Eagle Yllit dhe Ponte Prizrenit



Prishtinë, 15 dhjetor - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e tetë e Prince Caffe Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshje interesante vlerësohet ajo ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Ponte Prizrenit. Të dyja skuadrat kanë grumbulluar nga 11 pikë, apo nga katër fitore dhe tri humbje, prandaj pritet një duel shumë interesant. Një ndeshje interesante vlerësohet edhe ajo ndërmjet Vëllaznimit dhe Rahovecit. Të dyja skuadrat hyjnë në këtë ndeshje shumë të motivuara. Skuadra kuqezi ka mundur Sigal Prishtinën dhe Pejën, e me sukses do të përpiqet ta kalojë edhe Rahovecin. Por, "Vreshtarët" fituan derbin e fundit ndaj Golden Eagle Yllit me 20 pikë dallim (76:96) dhe ndodhen në vendin e dytë me pesë fitore dhe dy humbje, kurse skuadra kuqezi ka tri fitore dhe katër humbje. Dita e enjte është e rezervuar për përballjet e skuadrave rivale ndërmjet tyre. Sigal Prishtina do të presë Pejën në një sfidë shumë interesante. "Bardhekaltrit" kanë dy fitore dhe pesë humbje, kurse pejanët janë në vendin e parë me gjashtë fitore dhe një humbje. Këto dy skuadra do të ballafaqohen edhe në çerekfinale të Kupës së Kosovës. Trepça dhe Bashkimi janë dy skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës. Sfida në 'Minatori' pritet të jetë shumë interesante, sepse të dyja skuadrat kanë nga dy fitore dhe pesë humbje në këtë edicion.

**PRINCE CAFFE SUPERLIGA - JAVA 8**

**Të mërkurën takohen:**
15:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni
15:00 Vëllaznimi - Rahoveci

**Të enjten takohen:**
15:00 Sigal Prishtina - Peja
15:00 Trepça - Bashkimi

## Veseli, MVP i xhiros së shtatë në Superligë

Në fundjavë u zhvillua xhiroja e shtatë në Prince Caffe Superligë, ku derbi Golden Eagle Ylli - Rahoveci përfundoi 76:96 për "Vreshtarët". Basketbollisti më i dalluar ishte Alban Veseli me 26 pikë, gjashtë kërcime dhe tri asistime, me një indeks 30. Veseli nga 12 tentime për tri pikë, gjashtë herë ishte i saktë, kurse për dy pikë ishte 4/4 apo 100 % i saktë dhe ndihmoi skuadrën të shënojë fitore shumë të rëndësishme. Ndërkohë, pesë shënuesit më të mirë të xhiros së shtatë ishin Alban Veseli i Rahovecit me 26 pikë, Musab Mala i Bashkimit me 26, Cendrik Council i Vëllaznimit me 26, Xavier Cannefax i Ponte Prizrenit me 24 dhe Isaiah Traylor Rahoveci me 23.

## SHKURT

### Gjilani shkatërroi KEK-un, debutim fantastik për Sokolin

SC Gjilani ka triumfuar me rezultat bindës 5-0 ndaj KEK-ut në kuadër të Kupës së Kosovës në fazën 1/16 e finales. Dy gola për Gjilanin i realizoi Darko Nikaç, kurse nga një e shtuan Muhamed Useini, Fiton Hajdari dhe Tomislav Busiç. Ky ishte takimi debutues për trajnerin Bylbyl Sokoli në krye të SC Gjilani.

### Januzaj: Do të jenë ndeshje të vështira për ne dhe Unitedin

Adnan Januzaj do të përballet me ish-skuadrën, Manchester United, në Ligën e Kampionëve. Januzaj ka thënë se kjo ndeshje do të jetë e vështirë si për Real Sociedadin, po ashtu edhe për Manchester Unitedin. "Jemi shumë mirë, po luajmë shumë mirë. Kemi ekip të ri, por me shumë kualitet. Tani e kemi David Silvan, që na sjell më shumë maturi në lojë. Ne, po ashtu, e kemi Nacho Monrealin, pra lojtarë që kanë luajtur në Premierë Ligë në të kaluarën. Do të jenë ndeshje të vështira për ata e për ne", ka thënë Januzaj.

### Xhemajli rikthehet te FC Zurich

Mesfushori shqiptar me pasaportë zvicerane, Blerim Xhemajli, nga edicioni i ri pritet të ndërrojë mjedis. Sipas mediave zvicerane, 34-vjeçari ka arritur marrëveshje me FC Zurichun për t'u rikthyer në Superligën e Zvicrës. Xhemajli ka disa javë që është futbollist i lirë pasi ka përfunduar karrierën me skuadrën kineze Shenzen. Xhemajli u largua nga Zurich në verën e vitit 2007 dhe kaloi te Bolton Wanderersi kur ishte 21-vjeçar. Te Zurichu, Xhemajli do të luajë përkrah yjeve të Kosovës si Beniamin Kololli, Hekuran Kryeziu e Fidan Aliti.

### Deçani, kampion vjeshtor në Ligën e Parë

Ka përfunduar stinori vjeshtor në Ligën e Parë të Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. U zhvillua një garë e mirë, ndërsa në skuadra kanë parakaluar shumë hendbollistë të talentuar. Sa u përket rezultateve, është shquar Deçani, që ka fituar të nëntë ndeshjet. Me 18 pikë, Deçani është kampion vjeshtor në Ligën e Parë. Vlera kanë shfaqur edhe Samadrexha, Rahoveci, Lepenci, Ulpiana, Drita, KEK-u, Vjosa, Dukagjini e Istogu. Garë edhe më e mirë pritet në pjesën e dytë të kampionatit.

### Ujkani shërohet nga Covidi

Portieri i Kosovës, Samir Ujkani, është shëruar nga koronavirusi. Ai tashmë është i gatshëm t'i bashkohet skuadrës së Torinos në stërvitje. Ujkani ishte i infektuar gjatë grumbullimit me Kosovën dhe ishte i izoluar në Torino. Lajmin për shërimin nga Covid-19 e dha vetë Ujkani në rrjetet sociale. Ujkani ishte edhe i fundit i shëruar nga lojtarët që ishin pozitiv. Para pak ditësh nga koronavirusi është shëruar edhe mbrojtësi i Kosovës, Mërgim Vojvoda që, po ashtu, u infektua gjatë grumbullimit me Kosovën në muajin e kaluar.

### Rexhbeçaj në formacionin e javës në Bundesliga

Mesfushori shqiptar Elvis Rexhbeçaj është përfshirë në formacionin më të mirë të javës në kampionatin gjerman. 23-vjeçari ishte vendimtar në fitoren e Kolnit në udhëtim te Mainzi, në të cilën e shënoi edhe golin në vlerën e tri pikëve. Paraqitja e futbollistit shqiptar është vlerësuar nga ekspertët e Bundesligas, të cilët e kanë përfshirë në formacionin e javës.

## Ish-presidenti i Ferrarit: Jam gati të rikthehem



MARANELLO, 15 DHJETOR - Luca di Montezemolo, ish-presidenti i Ferrarit, njeriu që udhëhoqi "kokëkuqen" drejt sukseseve të mëdha në Formula 1 në kohën kur pilotonte Michael Schumacher, u shpreh i gatshëm të marrë sërish drejtimin e makinës së njohur italiane. "A mund të rikthehem te Ferrari? Këtë gjë nuk ma ka kërkuar ende njeri, por jam gati. Mendoj se e di se cilat janë problemet aktuale te Ferrarit. Unë i kam dhënë shumë dhe tani shoh me keqardhje një makinë që parakalohet dhe që nuk arrin të duelojë për fitoren", ka thënë Montezemolo. "Ky është një Ferrari ndryshe nga ai që drejtoja unë. Shpresoj që të zgjedhin një drejtues të saktë pas dorëheqjes së Camilleri, pasi duhet forcuar një skuadër. Nëse duan këshillën apo ndihmën time, unë jam gati", ka deklaruar Montezemolo.

# Komisioni i Gjyqtarëve: Ndaloni fyerjet dhe ofendimet ndaj gjyqtarëve



PRISHTINË, 15 NËNTOR - Komisioni i Gjyqtarëve i Futbollit të Kosovës ka reaguar të martën lidhur me presionin, fyerjet, linçimet dhe ofendimet e bëra nga trajnerët dhe zyrtarët e klubeve në drejtim të gjyqtarëve të cilat kanë ndodhur gjatë këtij kampionati dhe kanë kulmuar në javën e fundit. "Komisioni i Gjyqtarëve dënon ashpër veprimet e tilla, ku në mënyrë të shëmtuar dhe shpeshherë pa një analizë paraprake profesionale, menjëherë pas ndeshjes gjyqtarët janë atakuar në format më vulgare të mundshme. Situatat e tilla nuk i përkasin aspak futbollit dhe janë kundër frymës që promovon sporti, e që ka për qëllim të krijojë një ambient pozitiv për secilin pjesëmarrës në futboll dhe komunitetin jashtë tij", thuhet në reagimin e Komisionit të Gjyqtarëve. "Është evidente se edhe gjyqtarët gabojnë, ashtu siç gabon çdo aktor në fushën e futbollit jo vetëm te ne, po kudo në botë. Asnjëherë nuk kemi pretenduar që saktësia e tyre është 100 %, mirëpo ajo çfarë ne e themi me bindje të plotë është se gabimet e tyre janë njerëzore. Gjyqtarët në çdo ndeshje japin 100 % e tyre dhe komisioni punon që të ngrehet niveli i edukimit të tyre në fushën e referimit, duke ofruar ligjërata dhe trajnime nga instruktorët më kompetentë të FIFA-s dhe UEFA-s, në mënyrë që gabimet e tyre të shkurtohen në nivelin më të vogël të mundshëm", thuhet në reagimin e Komisionit të Gjyqtarëve të FFK-së.

Komisioni i Gjyqtarëve është anëtar i rregullt i Konventës së Gjyqtarëve të UEFA-s dhe çdo gjyqtar i futbollit rregullisht testohet në njohjen e rregullave të lojës dhe aspektin fizik. Për më tepër, secili nga ta, në secilën ndeshje, vlerësohet për performancën e tij që e bën gjatë gjithë ndeshjes (jo vetëm episodet e caktuara të lojës) dhe secili nga ta radhitet në bazë të paraqitjes, personalitetit, shkathtësisë dhe shumë elementeve të tjera. Për më tepër, çdo gabim i tyre analizohet dhe nuk kalon pa e pasur trajtimin adekuat nga komisioni i vlerësimit dhe meritës. Prandaj, Komisioni i Gjyqtarëve ka kërkuar që të lihet i qetë në punën e tij të cilën e bënë me shumë përkushtim dhe pasion. Përkundër të gjitha këtyre presioneve, gjyqtarët përsëri e kanë të njëjtën vendimmarrje dhe ajo gjithmonë bazohet ne Rregullat e Lojës së Futbollit. "Ne besojmë në integritetin e secilit gjyqtar që e caktojmë në ndeshjet e futbollit dhe ua japim mbështetjen e plotë për punën e tyre. Gjithsesi, inkurajojmë klubet që për çdo dyshim të faktuar që kanë lidhur me ndonjë veprim të parregullt nga ana e gjyqtarëve t'i denoncojnë ata menjëherë në organet e FFK-së dhe ato të drejtësisë. Institucioni ynë garanton se nëse dëshmohet ndonjë veprim i tillë, masat për aktorët do të jenë radikale dhe të njëjtët do të përjashtohen përjetësisht nga futbolli. Prandaj, edhe një herë shpresojmë që aktet e tilla të shëmtuara të javëve të fundit të ndalohen ngaqë, përveç që e dëmtojnë reputacionin e shtetit tonë, futbollit, gjyqtarëve dhe familjeve të tyre, dëmtojnë edhe imazhin e klubeve tuaja", thuhet në reagimin e Komisionit të Gjyqtarëve.

# Bastet zbulojnë skuadrat favorite për ta fituar Ligën e Kampionëve




MUNCHEN, 15 DHJETOR - Bayern Munchen është sërish favorit për ta mbrojtur trofeun e Ligës së Kampionëve. Kompanitë evropiane të basteve e kuotojnë triumfin e fituesve të tripletës sezonin e shkuar me koeficient 3.75, ndërsa pas tyre renditet Manchester City me koeficientin 5. Ndjek kampioni i Anglisë, Liverpooli, me 7 dhe Juventusi dhe PSG-ja mbyllin pesëshen e parë.

Klasifikimi, ekipi, koeficienti: Bayern (3.75), Man City (5.00), Liverpool (7.00), Juventus (12.00), PSG (13.00), Real Madrid (15.00), Barcelona (18.00), A. Madrid (18.00), Chelsea (18.00), Dortmund (20.00), Leipzing (33.00), Atalanta (40.00), Sevilla (50.00), Lazio (80.00), Gladbah (100.00), Porto (150.00).

## SHKURT

### Tare: Gjynah që Cikalleshi ta humbasë karrierën në Turqi

Drejtori sportiv i Lacios, Igli Tare, i ka thurur elozhe sulmuesit të kombëtares, Sokol Cikalleshi, teksa e ka cilësuar si lojtarin që e intrigon më tepër. Sipas Tares, është gjynah që Cikalleshi ta humbasë karrierën në një kampionat turk. "Unë e kam thënë para disa vitesh, se lojtari që më intrigon më tepër është Sokol Cikalleshi. Është një lojtar që ka karakteristika shumë të mira si futbollist, por për këto karakteristika që ka, ka punuar shumë pak në jetën e tij dhe është gjynah që ta humbasë karrierën në një kampionat si ai turk. Me gjithë respektin që kam për kampionatin turk, por ai lojtar duhet të kishte bërë shumë më tepër në karrierën e tij sepse për llojin e tij është një lojtar i cili është shumë i domosdoshëm për kombëtaren shqiptare", u shpreh Tare për emisionin "Ditë e Re".

### Gjashtë raste me Covid në Premierë Ligë

Premierë Liga ka konfirmuar gjashtë raste me Covid-19 në testet e bëra për lojtarët dhe stafin. 1 549 testime janë bërë mes datave 7-13 dhjetor, ndërsa gjashtë prej tyre kanë dal pozitivë. Javën e kaluar ka pasur 14 raste pozitive mes datave 30 nëntor - 6 dhjetor dhe besohet se janë nga ndeshja Newcatle United - Aston Villa që u suspendua më 4 dhjetor. Sidoqoftë, pavarësisht prej rasteve, ndeshjet do të vazhdojnë të zhvillohen normalisht.

### Juve kishte ofruar dy futbollistë për Pogban

Juventusi vazhdon të mos heqë dorë nga transferimi i Paul Pogbas dhe do të bëjë çdo tentativë të mundshme për ta rikthyer në Torino në dy sesionet e ardhshme të merkatos. Juventusi e ka tentuar Pogban në verë, duke ofruar Miralem Pjaniqin dhe Douglas Costan. Manchester Unitedi në fund nuk e ka pranuar këtë propozim dhe ka vendosur ta mbajë Pogban, që nuk është aspak i lumtur në "Old Trafford". Gjithsesi Pogba është një opsion për Juven, sidomos për merkaton e verës së ardhshme dhe nuk përjashtohet as një shkëmbim i mundshëm me Paulo Dybalan.

### Lewandowski: Ja pse zgjodha Gjermaninë para Italisë

Robert Lewandowski ka zbuluar një prapaskenë interesante rreth të kaluarës së tij. Polaku i Bayern Munchenit është prej vitesh një nga sulmuesit më të mirë në planet. Gjithmonë konstant dhe deciziv në ndeshjet e tij dhe gola pa fund ndaj çdo kundërshtari. Ishte viti 2010, 32-vjeçari luante me Lech Poznanin dhe po bëhej gati të hidhte një hap të rëndësishëm në karrierë. Genoa e kërkoi, Lewa ishte shumë afër kalimit në Serinë A, por në fund zgjodhi Borussia Dortmundit dhe bëri shumë mirë. "Në Itali luajnë shumë futbollistë nga Polonia. Kur isha më i ri dhe aktivizohesha me Lech Poznan, mund të zgjidhja midis disa skuadrave për ta vazhduar karrierën, përfshirë edhe ato italiane. Isha shumë afër transferimit te Genoa. Vizitova stadiumin dhe qendrën stërvitore të klubit, por unë doja një ekip që luante në Champions League dhe zgjodha Dortmundin. Mendoj se mora një vendim të mirë duke parë se ku kam mbërritur tani", deklaroi bomberi i njohur polak i Bayern Munchenit.

### Sharapova: Ja pse vendosa të tërhiqem nga sporti

Në shkurt të këtij viti tenistja ruse Maria Sharapova vendosi të tërhiqet nga sporti në moshën 33-vjeçare. Një lamtumirë disi e papritur kjo e tenistes bukuroshe që, në fakt, prej disa vitesh nuk po arrinte të jepte atë që të gjithë prisnin në fushë. Duke folur për mediat, në lidhje me tërheqjen e saj nga sporti, Sharapova ka deklaruar: "Edhe pse isha e përqendruar, kuptova se po lodhesha kot duke luajtur, pasi si teniste e kisha humbur kontaktin me kompeticionin. Kjo e bëri të vështirë të gjithë procesin. Bashkë me stafin tim kuptova se nuk do të merrja më asgjë nga fusha e tenisit dhe se duhej të përqendrohesha në aktivitete të tjera. Nuk doja që të më njihnin vetëm si ish-fituese. Nëse do të merresh me sport duhet të jesh 100 % në çdo drejtim. Unë kisha humbur shumë kontakt me këtë sport".

## Invitation for Bids
## (Without Prequalification)

**KOSOVO**
**WATER SECURITY AND CANAL PROTECTION PROJECT**
**Credit No: 5902-XK**
**Contract Title: Rehabilitation Works for Iber Lepenc Canal**
**Reference No**: WSCP–W-ICB–3

The ***Government of Kosovo*** has received *financing* from the World Bank toward the cost of the ***Water Security and Canal Protection Project***, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for ***Rehabilitation Works for Iber Lepenc Canal***.

The ***Iber Lepenc Company (ILC)*** now invites sealed bids from eligible bidders for the **Works for New Water Storage/Dam and Pumping Station at Mihaliq**, including inter alia the following key works:

- Earth Dam;
- New Pumping Station
- Preassure Pipeline to DO-2;
- New Access Road
- Spillway
- Water Intake
- Service Bridge
- GWM (Ground Water Measurement Points)
- Other Works

The objective of the project is to build a reservoir with the required storage size of approx. 3.7 million m³. The Mihaliq Emergency Reservoir (ERM) ends with dike/earth dam of around 680 m length a 36 m height.

The proposed location of the emergency reservoir (ERM) is near Mihaliq village in the Municipality of Vushtrri. The water would have to be raised by about 20 m above from the Ibër Canal for filling the reservoir. The water withdrawal from the reservoir would be sent via an approximately 2 km long gravity pipe upstream and parallel to the Iber Canal to North where it enters into the Iber Canal Diversion regulator structure DO2. From DO2 an existing water pipeline of the Prishtina Municipal regional Water Company is connected.

The pipe is on ILC property and no expropriation is required for the pipe trace. There will be no physical relocation of people from the reservoir area. A few houses with a sheep farm are located close to the reservoir at the North-West reservoir shore but do not need expropriation. Their levels are above 580 MSL.

With a live storage of 3.4 Million m3, during off-irrigation period, a closure of 40 days of the sections upstream of DO2 would be possible.

The **period of construction is 24 months**.

Bidders with the following minimum key qualifications are eligible for contract award. The Bidder shall furnish documentary evidence that it meets the following experience and financial requirements:

- At least **2** contract of minimum value **Euro 8,000,000 inclusive of VAT.** Similarity of contracts shall be based on execution of projects including new construction, rehabilitation, repair of large earth fill dams (volume **not less than** 1 million m3 and/or height of **not less than** 15 m) or equivalent dam structures with related reservoir systems and water conveyance systems
- Minimum average annual construction turnover of **Euro 10,000,000** or equivalent, calculated as total certified payments received for contracts in progress and/or completed within the last *3* years, divided by *3* Years. For this purpose **Years 2017, 2018 and 2019** will be used.
- Access to, or has available, liquid assets, unencumbered real assets, lines of credit, and other financial means (independent of any contractual advance payment) sufficient to meet the construction cash flow requirements estimated as **Euro 1,500,000** or equivalent for the subject contract net of the Bidders other commitments (this shall also include at least **Euro 750,000** as cash availability in bank or a confirmation from a bank to offer a valid line of credit from bank for the subject contract)
- Minimum specific construction experience in the following key activities successfully completed within the last 5 years[1]:

**<u>Generic Construction Work Activities</u>**

(a) Earthworks for Dam or embankment filling and compaction of minimum 1,000,000 $m^3$

(b) Concrete works in dam related civil works or similar large hydraulic structures of minimum 15,000 $m^3$

(c) Structural Steel Works of minimum 1,000 tonnes (t)

**<u>Specific Construction Structures/Activities</u>**

(a) Construction of Clay Core Earth Fill Dam with a minimum height of 15 m and a crest width of minimum 7 meters (m)

(b) RC Water Intake Tower construction with minimum height of 21 meters (m) and minimum diameter of 3 meters (m)

(c) Footbridge construction (span width 30 meters (m)

(d) Embankment construction with Rip-Rap Protection of a minimum volume of 30,000 cubic meters (m³)

(e) Geosynthetic-Textile installation works of minimum 30,000 square meters (m²)

(f) Underground Electical Transmission Cabling work of minimum length 5,000 meters (m)

**<u>Specialized Works</u>**

For the following **specialized works**, the Employer permits specialized sub-contractors in case the main contractor lacks suitable experience:

(a) Pumping Station (based on Centrifugal Pumping Systems) Capacity of at least 320 litres/second and Head of around 24 meters including all civil, architectural, hydraulic and electro-mechanical equipment and piping). At least **2 projects** of minimum value **Euro 400,000** or **1 project** of minimum value **Euro 800,000**

(b) Installation of GRP (Glass Reinforced Plastic) Pressure Piping – 1320 m; Steel pipe – 240 ton, diameter – 1000 mm. At least **2 projects** each of minimum value **Euro 250,000** or at least **1 project** with minimum value **Euro 500,000.**

Bidding will be conducted through the International Competitive Bidding procedures as specified in the World Bank's *Procurment Regulations: Procurement in Investment Project Financing – Goods, Works, Non Consulting and Consulting Services – July 2016, Revised November 2017 and August 2018* , and is open to all eligible bidders as defined in the Procurement Regulations. In addition, please refer to paragraphs 3.14 and 3.15 setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Interested eligible bidders may obtain further information from:

*HE "Iber Lepenc" JSC*
*No 13 Bill Clinton Avenue,*
*Pristina, Kosovo*
Attention: Vigan Syla (Project Coordinator – WSCPP)
Telephone: *+ 383 38 525 006*
Email: vigan.syla@iber-lepenc.org
With cc to: fhadja@gmail.com and dmajumdar123@yahoo.com and info@iber-*lepenc.org*

and inspect the bidding documents during office hours from **9 am to 4 pm on normal working days between Monday to Friday** at the address given below.

A complete set of bidding documents in **English** language may be purchased by interested eligible bidders upon the submission of a written application to the address below and upon payment of a nonrefundable fee of **Euro 200**. The method of payment will be cash payment or bank transfer to:

| | |
|---|---|
| User: | **NH IBER LEPENC SHA - WB** |
| Bank: | **BANKA KOMBTARE TREGTARE - KOSOVA** |
| Account number: | **1901 2179 3504 1302** |
| Swift code: | **NCBAXKPR** |
| IBAN: | **XK051901217935041302** |

The document will be hand delivered to the Bidder or be sent by courier to the address specified by the Bidder if specifically requested by the Bidder. For the convenience of Bidders an electronic copy of the Bidding Documents may be sent to Bidders who request for the same at the email address indicated by the Bidder. **The electronic copy of the Bidding Document will be issued to Bidders after receipt of bidding document purchase payment confirmation details from the Bidder**

Bids must be delivered to the address below on or before **29 January 2021 (10.00 Hours).** Electronic bidding will not be permitted. Late bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the bidders' designated representatives and anyone who choose to attend at the address below on **29 January 2021 (10.00 Hours)**.

All bids must be accompanied by a **Bid Security of Euro 150,000.**

The address referred to above is:

*HE "Iber Lepenc" JSC*
*Protocol Office*
*No 13 Bill Clinton Avenue,*
*Pristina, Kosovo*
Attention: Vigan Syla (Project Coordinator – WSCPP)
Telephone: *+ 383 38 525 006*







Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit*
*Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine*
*Ministry of Economy and Environment*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 4076/20 të datës 11.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

**Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Alfa Minerals and Alloys” L.L.C Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:**

**DEBAT PUBLIK**

**Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e impiantit për përfitimin e kromit të varfër në Gjakovë.**

**Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2021 në ora 10:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë “Alfa Minerals and Alloys” L.L.C Zona Industriale, pran rrugës regjionale Gjakove-Prizren numër R107 (në hapësirat e ish ndërmarrjes Hollding Metaliku) në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania “Alfa Minerals and Alloys” L.L.C Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.**

**Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e impiantit për përfitimin e kromit të varfër në Gjakovë.**

**Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM**

https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Adil Gurgusha shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Nehat Dana shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jeton Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Majlinda Kajdomqaj shpall të pavlefshme dëftesat e jl VI - IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

▶ Hysen Rama shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.E.J. “Hoxhë Kadri Prishtinë” Prishtinë.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përballë "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania ‘’Kushtrimi AD 1’’ Sh.p.k. Rogovë, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e inerteve rërës dhe zhavorrit në vendin Llukaj zona kadastrale Rogovë komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2021 në ora 11:30 në hapësirat e zyrës së kompanisë ‘’Kushtrimi AD 1’’ Sh.p.k. në Rogovë komuna e Gjakovës do të organizohet debat publik nga kompania ‘’Kushtrimi AD 1’’ Sh.p.k. Rogovë, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e inerteve rërës dhe zhavorrit në vendin Llukaj zona kadastrale Rogovë komuna e Gjakovës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNUNGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Shehu Sh” Sh.p.k Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2021 në ora 09:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë “Shehu Sh” Sh.p.k rruga Pn. “UÇK” në Rahovec do të organizohet debat publik nga kompania “Shehu Sh” Sh.p.k Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Rahovec.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNUNGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.




Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.
Zymber Kelmendi
***
Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.
Kristë Shtufi
***
Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve te shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.
Fadil Sahiti
***
... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...
Orhan Kerkezi
***
Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.
Daut Dauti
ISBN 978-9951-780-37-7
ÇMIMI: 5.99 €
AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI
ARMAGEDONI
AGRON SHALA
DEKALOGU
nga Moisiu deri te Kieślowski


Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.
Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve Bota e re, pastaj në revistën Zëri. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i Zërit nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.
Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan Kettering Foundation ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.
Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.
Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.
ISBN 978-9951-780-10-0
4.99 €
Daut Dauti • NJË PALË KËPUCË NË BERLIN
Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN
novelë
ARMAGEDONI